

Dëshiron t'a lexosh këtë letër në një gjuhë tjetër? Shiko në internet në <http://documenten.mijninburgering.be>.

Data [XXX]

Vendi [XXX]

Numri yt në regjistrin kombëtar [XXX]

## Ftesë: trajekt i integritit

I/e nderuar [XXX],

Ka pak kohë që ti banon në Flandër, ose sapo e ke marrë lejen e qëndrimit. Mirë se erdhe!

Ne dëshirojmë që ti të ndihesh këtu si në shtëpinë tënde. Prandaj ne dëshirojmë të të ftojme për trajektin e integritit. Trajekti të ndihmon që të orientohesh shpejt në Flandër.

## Çfarë është trajekti i integritit?

Gjatë trajektit të integritit ti mëson ndër të tjera:

- se ku mëson holandisht;
- se si gjen një punë (tjetër), apo fillon një aktivitet tëndin privat;
- se si mund të bësh, që të njihet diploma jote në Belgjikë;
- se ku gjen një kurs trajnimi;
- se ku gjen një shkollë për fëmijët e tu;
- se çfarë mund të bësh në kohën tënde të lirë;
- se si e gjen një banesë të mirë;
- se tek kush mund të kërkosh ndihmë, kur ti apo ndonjëri nga familja jote sëmuret.

Ti mëson edhe më shumë gjëra. Lejohet gjithashtu që ti të bësh pyetjet e tua.

## Cilat janë avantazhet e trajektit të integritit?

- Trajekti i integritit ofron mundësi për ty dhe familjen tënde. Ti mëson si të orientohesh në shoqërinë tonë.
- Ti njihesh me njerëz të tjerë.
- Nuk ke kompjuter apo laptop? Në këtë rast lejohet të përdorësh një tablet për kursin dixhital orientim në shoqëri.

- E ke mbaruar me sukses trajektin e integritit? Në këtë rast të jepet një vërtetim i integritit. Ka mundësi që ky vërtetim të ndihmojë për të përfituar shtetësinë belge.

### **Çfarë bën ti gjatë trajektit të integritit?**

1. Një udhëzues i trajektit bën marrëveshje me ty, për ku dhe kur ti e ndjek trajektin e integritit. Ty të jepet udhëzim në planet e tu afatshkurtër dhe afatgjatë.
2. Çfarë duhet që ti të dish dhe të bësh, për të kuptuar këtë vend/shtet dhe për t'i dhënë sa më tepër mundësi vetes dhe familjes tënde? Këtë e mëson gjatë mësimëve orientim në shoqëri, në gjuhën tënde, apo në një gjuhë që ti e flet mirë.
3. Ndoshta ti flet tashmë pak holandisht, apo ndoshta akoma jo? Ti mëson holandisht në nivelin bazë/fillestar. Dëshiron të mësosh më tepër holandisht apo të ushtrohesh? Ne të japim informacione mbi kurset e holandishtes, ose mbi mundësitë për të ushtruar holandishten tënde.
4. Nuk ke gjetur akoma punë? Në këtë rast ne të adresojmë tek VDAB-ja. VDAB-ja të udhëzon për të kërkuar punë. Një punë ofron të ardhura dhe një mundësi shtesë, për të mësuar dhe për të ushtruar holandishten.
5. Ti merr pjesë në një trajekt të pjesëmarrjes/angazhimit në shoqëri. Kështu ti mund të njihesh më mirë me komunën tënde (qytetin tënd) dhe mund të ushtrosh holandishten jashtë klasës. Ne kërkojmë bashkë me ty aktivitete, punë vullnetare apo stazhe/praktikë.

### **Ku dhe kur e ndjek ti trajektin e integritit?**

Kohëzgjatja e një trajekti të integritit ndryshon nga personi në person. Udhëzuesi yt i trajektit harton bashkë me ty një trajekt të përshtatshëm.

### **Sa kushton trajekti i integritit?**

- |                                                 |                          |
|-------------------------------------------------|--------------------------|
| 1. Udhëzimi në trajekt                          | Falas                    |
| 2. Mësime Orientim në Shoqëri                   | € 180 (përfshirë 1 test) |
| 3. Mësime të holandishtes                       | € 180 (përfshirë 1 test) |
| 4. Udhëzimi për punën                           | Falas                    |
| 5. Trajekt i pjesëmarrjes/angazhimit në shoqëri | Falas                    |

Nuk e ke kaluar testin dhe e bën testin përsëri? Ti paguan përsëri për testin.

Ndonjëherë ti nuk duhet të paguash. Gjatë takimit të parë të jepen informacione mbi pagesën dhe përjashtimet e mundshëm nga detyrimi për të paguar.

**Çfarë duhet të bësh?**

Merr një takim tek [XXX] . Telefono tek [XXX].

Adresa është: [XXX]

Ne të japim me dëshirë informacione të mëtejshëm.

Dëshiron t'a ndjekësh trajektin e integritit në një vend tjetër? Në [XXX] ti gjen të gjitha adresat.

**Dëshiron informacione të mëtejshëm?**

Informacione të mëtejshëm mund të gjesh në faqen në internet <http://www.inburgering.be>.

Mirupafshim së shpejti!

Përshëndetje miqësore,

[XXX]

DUMMMY